



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202002293/5

Tiranë ___/___/2021

Lënda: *Rekomandim për analizimin e rastit të punonjësve të Policisë Bashkiake Tiranë të cilët kanë kyer veprime me shtetasin S. S.*

DREJTORIT TË POLICISË BASHKIAKE
Tiranë

Për dijëni: Z. S. S.
Babrru Shpat

Tiranë

Me shkresat nr. K2/S1-2 prot., datë 16.01.2020, nr. K2/S1-5 prot., datë 24.02.2020 dhe nr. K2/S1-3 prot., datë 03.09.2020 ju kemi vënë në dijeni se në Institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetasi S. S. me banim në Babrru Shpat, Tiranë. Ankuesi shkruan se është anëtar i komunitetit rom dhe se familja e tij përbëhet nga 6 anëtarë dhe ka 4 fëmijë me moshë nga 4 muaj deri në 7 vjeç. Deri në muajin qershor 2019 ai merrte ndihmë sociale, por pas verifikimit të bërë nga punonjësi social është konstatuar se kishte një TV Plazëm në banesë dhe për këtë arsye ia ndërprente ndihmën sociale. Meqënëse është i papunë dhe në kushte të vështira ekonomike, është regjistruar si punëkërkuar në Eco Tirana për t'u punësuar, por deri në momentin e bërjes së kësaj ankese nuk i ishte ofruar ndonjë vend pune.

Në datën 06.01.2020, në orën 10:00 ka qenë në zonën prapa Komisarariatit të Policisë nr. 4 Tiranë duke mbledhur mbeturina të riciklueshme me qëllim për t'i shitur dhe siguruar të ardhura për jetesë për familjen e tij. Aty kanë shkuar disa punonjës të Policisë Bashkiake Tiranë dhe i kanë sekuestruar mbetjet e mbledhura si dhe mjetin (karrocën) me të cilat ai i transportonte ato. Ankuesi pretendon se mjetin e ka për nevoja pune dhe se ai i është marrë në mënyrë të paligjshme dhe pa mbajtur asnjë dokument.

Në bazë të kërkesës tonë, ju me shkresën nr. 2416/1 prot., datë 27.01.2020, ndërmjet të tjerave na informuat se, referuar nenit 2 të ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996 "Për largimin publik të

mbeturinave”, të gjitha llojet e mbetjeve, sipas përcaktimit të bërë në këtë ligj, pas dorëzimit të tyre janë pronë shtetërore.

Ndërsa në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Tiranë “Për administrimin e mbetjeve urbane dhe pastrimin e qytetit”, neni 5, pikat 28 dhe 29, përcaktohet statusi i pronësisë së këtyre mbetjeve si dhe domosdoshmëria e mbrojtjes së shëndetit publik nga keqpërdorimi i tyre. Gjithashtu në nenin 50, pika 168 të kësaj rregulloreje parashikohet se, është e ndaluar nga qytetarët dhe çdo person i paautorizuar të kryejë çdo lloj seleksionimi manual të mbetjeve të dorëzuara brenda kontenierëve, kërkim apo marrje të mbetjeve të dorëzuara në kontenier ose pranë impianteve të rikuperimit dhe përpunimit final.

Për sa më sipër dhe në zbatim të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Bashkiake”, i ndryshuar, konkretisht nenit 8/2, në të gjitha rastet kur konstatohen persona që kanë ndërhyrë në kontenierët e mbetjeve urbane, duke seleksionuar apo marrë mbetje, janë ndaluar dhe mbetjet e nxjerra u janë marrë dhe dërguar në Landfillin e Tiranës, si impianti i rikuperimit dhe përpunimit final të tyre. Për disa raste ndaj këtyre shtetasve janë bërë edhe kallëzime penale pranë organeve të Policisë së Shtetit për veprën penale të “Vjedhjes”, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal.

Përveç sa më sipër, na informuat se në lidhje me pretendimet për mjetet e personave të cilët kanë ndërhyrë në kontenierët e mbetjeve urbane, nuk është identifikuar ndonjë mjet me dokumentacion pronësie apo dokument tjetër që të vërtetojë llojin e mjetit dhe/apo pronësinë e tij.

Në përgjigjen e dërguar nga ana juaj nuk na informuat në lidhje me pretendimin konkret të ankuesit për bllokimin apo sekuestrimin e pa drejtë të mjetit të tij si dhe bazën ligjore të këtij veprimi. Për këtë arsye me shkresën nr. K2/S1-5 prot., datë 24.02.2020 ju kërkua informacion shtesë lidhur me sa më poshtë:

1. Cila është baza ligjore e bllokimit/sekuestrimit të mjetit të ankuesit?
2. A është mbajtur ndonjë procesverbal nga ana e punonjësve të policisë bashkiake lidhur me këtë veprim?
3. Çfarë veprimesh duhet të bëjë ankuesi për të bërë të mundur marrjen/kthimin e mjetit të tij?
4. Së bashku me informacionin ju kërkua edhe fotokopje të dokumentacionit të mbajtur nga punonjësit e Policisë Bashkiake lidhur me këtë rast.

Ndonëse na kthyet përgjigje me shkresën nr. 2416/5 prot., datë 02.04.2020, përsëri nuk na dërguat informacionin dhe kopjen e dokumentacionit të kërkuar nga ana jonë. Për të bërë të mundur shqyrtimin e kësaj ankese, me shkresën nr. K2/S1-3 prot., datë 03.09.2021 ju rikërkua informacionin për pyetjet e parashtruara më sipër, por sërish ju nuk na e dërguat atë.

Ky qëndrim është tregues dhe na krijon bindjen se veprimet dhe mos veprimet e punonjësve të Policisë Bashkiake në këtë rast nuk janë kryer në përputhje me aktet normative në fuqi e nuk është mbajtur asnjë lloj dokumentacioni.

Konkretisht në nenin 10 të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 për “Organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës” parashikohet se:

“Kur gjatë kryerjes së shërbimit konstatohen elemente të veprave penale, punonjësit e policisë së bashkisë dhe të komunës, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale marrin masa për shoqërimin e autorëve në komisariatit e policisë, ruajnë vendin e ngjarjes, fiksojnë dëshmitarët dhe ruajnë provat deri në ardhjen e policisë gjyqësore”.

Sipas përgjigjes së dërguar nga ana juaj, veprimet e punonjësve të Policisë Bashkiake në këtë rast janë bazuar në nenin 8/2 të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, të ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave” dhe në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Tiranë “Për administrimin e mbetjeve urbane dhe pastrimin e qytetit”, neni 5, pikat 28 dhe 29.

Meqënëse sipas nenit 2 të ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, të gjitha llojet e mbeturinave, pas dorëzimit të tyre janë pronë shtetërore, rezulton se “marrja” e tyre nga kontenierët është veprë penale dhe konkretisht “Vjedhje”, e parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal. Këtë fakt e pranoni edhe ju në përgjigjen e dërguar në të cilën shpreheni se, *për disa raste ndaj këtyre shtetasve janë bërë edhe kallëzime penale pranë organeve të Policisë së Shtetit për veprën penale të “Vjedhjes”, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal.*

Ndonëse në rastin në shqyrtim, nga shtetasi S. S. është kryer vepra penale e vjedhjes, punonjësit e policisë që e kanë konstatuar atë nuk kanë zbatuar detyrimin ligjor të përcaktuar në nenin 10 të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 të cituar më sipër dhe në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale për marrjen e masave të nevojshme për shoqërimin e autorit në Komisariatit e Policisë, ruajtjen e vendit të ngjarjes, fiksimit e dëshmitarëve dhe ruajtjen e provave deri në ardhjen e policisë gjyqësore, përpilimin e procesverbalit të kapjes në flagrancë, etj.

Ndërsa në “Rregulloren e brendshme "tip" të Policisë Bashkiake e të Komunës”, miratuar Urdhrin e përbashkët nr.1 datë 17.04.2003 të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe të Ministrit të Rendit Publik përcaktohet si vijon:

a) Neni 14 “Të drejtat e punonjësit e Policisë Bashkiake e të Komunës”, pika 9.

“9. Punonjësit e Policisë Bashkiake e të Komunës kanë atributet e oficerit e të agjentit të policisë gjyqësore vetëm në përputhje me Kodin e Procedurës Penale, të ligjit përkatës e sipas udhëzimit nga organet kompetente”.

b) Neni 23 “Veprimet në rast të kryerjes së një vepre penale”.

“1. Për veprat penale njoftohet menjëherë policia gjyqësore (Komisariati i Policisë) dhe në varësi të rasteve të bëhet: me marrjen dijeni dhe pa vonese.

*2. Edhe pas raportimit, punohet në parandalimin e pasojave të mëtejshme:
- në kapje të autorëve;*

- në ruajtjen e vendit të ngjarjes;
- në sigurimin e provave për të dokumentuar veprën penale;
- në sigurimin e dëshmitarëve të pranishëm.”

Nga dispozitat e cituara më sipër rezulton, se punonjësit e Policisë Bashkiake kanë atributet e oficerit e të agjentit të policisë gjyqësore dhe për rrjedhojë në këtë rast ata duhet të kryenin të gjitha veprimet e parashikuara në nenet 300, 301 dhe 303 të Kodit të Procedurës Penale¹. Pra, referuar këtyre dispozitave ata ndërmjet veprimeve të tjera duhet të kryenin sekuestrimin e mbetjeve të riciklueshme të cilat ishin vjedhur nga kontenerët e grumbullimit nga ana e shtetasit S. S., e të mjetit me të cilat ai po i transportonte ato, si dhe duhet të kishin përpiluar/mbajtuar procesvebalet përkatëse të sekuestrimit të tyre. Mos kryerja e këtyre veprimeve është mos kryerja e detyrimeve ligjore, por ndërkohë ky qëndrim lë shteg dhe krijon premisa për abuzime në detyrë nga punonjësit e policisë lidhur me fatin e mbetjeve të riciklueshme dhe të mjeteve të marra/bllokuara shtetasve të kapur në këto raste. Theksojmë se, përpilimi/mbajtja e procesverbalit përkatës për çdo send të bllokuar apo sekuestruar nga punonjësit e strukturave shtetërore, qoftë ai edhe pa zot/pronar, është detyrim ligjor që duhet zbatuar në çdo rast dhe rrethanë. Në rastet kur njihet personi që i posedon ato, qoftë ai i ligjshëm ose jo, atij i jepet një kopje e procesverbalit të bllokimit apo sekuestrimit të tyre.

Përderisa nga punonjësit e Policisë Bashkiake nuk është bërë njoftimi/raportimi në organet e Policisë së Shtetit për rastin e shtetasit S. S., sikurse parashikohet në nenin 23/1 të Rregullores

¹ **Neni 300 “Verifikimet e ngutshme në vend”, parashikon se:**

1. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore marrin masa që gjurmët dhe sendet që i përkasin veprës penale të fiksohen e të ruhen dhe që gjendja e vendngjarjes dhe e sendeve të mos ndryshojnë para ndërhyrjes së prokurorit, kur ai ka njoftuar se do të marrë pjesë.
2. Kur ka rrezik që gjurmët dhe sendet të ndryshojnë ose të humbasin dhe prokurori nuk mund të ndërhyjë urgjentisht, oficerët e policisë gjyqësore kryejnë veprimet hetimore të domosdoshme dhe, kur është rasti, sekuestrojnë provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën penale.

Neni 301 “Vleftësimi i sekuestrës”, parashikon se:

1. Kur vë sekuestron, sipas nenit 300, policia gjyqësore shënon në procesverbal shkakun dhe i dorëzon një kopje të aktit personit, të cilit i janë sekuestruar sendet. Procesverbali i dërgohet pa vonesë dhe sidoqoftë jo më vonë se dyzet e tetë orë, prokurorit të vendit ku është zbatuar sekuestrja.
2. Prokurori, brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme, me vendim të motivuar vleftëson sekuestron, në qoftë se ekzistojnë kushtet, ose vendos kthimin e sendeve të sekuestruara. Kopja e vendimit i njoftohet menjëherë, por jo më vonë se 72 orë, të pandehurit, mbrojtësit dhe personit të cilit i janë sekuestruar sendet. Kundër tij mund të bëhet ankimi në gjykatë brenda dhjetë ditëve nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, nga personi të cilit i janë sekuestruar sendet dhe ai 171 që ka të drejtë t’i kthehen ato. Ankimi nuk pezullon zbatimin e sekuestrës.

Neni 303 “Dokumentimi i veprimeve të policisë gjyqësore”, parashikon se:

1. Policia gjyqësore dokumenton, qoftë edhe në formë të përmbledhur, të gjitha veprimet e kryera.
2. Policia gjyqësore mban procesverbal për:
 - a) kallëzimet dhe ankimet e paraqitura me gojë;
 - b) të dhënat përmbledhëse dhe deklaratimet e marra nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet;
 - c) të dhënat e marra nga personat që mund të tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit;
 - ç) këqyrjet, njohjet, kontrollimet dhe sekuestrimet;
 - d) aktet për identifikimin dhe njohjen e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, për marrjen e plikove ose të korrespondencës dhe për vënien e sekuestrës;
 - e) veprimet hetimore të deleguara nga prokurori.
3. Dokumentacioni i veprimeve të policisë gjyqësore, provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën penale vihen në dispozicion të prokurorit.

së cituar më sipër, dhe kur nga organi juaj nuk është referuar ndonjë veprë penale në organin procedues për këtë rast, atëhere bllokimi i mbeturinave të riciklueshme dhe i karrocës së tij është i kundërligjshëm. Gjithashtu ne vlerësojmë se kryerja e veprimeve të tilla nga punonjësit e Policisë Bashkiake, të cilat janë në kundërshtim të plotë dhe të hapur me ligjin, çënojnë rëndë autoritetin dhe besimin publik të Policisë Bashkiake.

Ndërkohë konstatojmë me shqetësim qëndrimin indiferent dhe mos reagimin e strukturave drejtuese të Policisë Bashkiake Tiranë ndaj shkeljeve ligjore të kryera nga punonjësit e këtij organi në rastin e shtetasit S. S.. Gjithashtu vlerësojmë se edhe konstatimi juaj se, *nuk është identifikuar ndonjë mjet me dokumentacion pronësie apo dokument tjetër që të vërtetojë llojin e mjetit dhe/apo pronësinë e tij*, nuk është korrekt dhe i bazuar. Është i njohur fakti që një numër i konsiderueshëm i personave që mbledhim mbetje të riciklueshme, të cilët i përkasin komunitetit rom, përdorin mjete të adaptuara dhe pa dokumentacion të rregullt për transportimin e tyre. Gjithsesi kjo situatë faktike nuk mund dhe nuk duhet të legjitimojë veprimet e kryera nga punonjësit e organit tuaj. Edhe në të tilla raste, nëse këto mjete bllokohen apo sekuestrohen nga punonjësit e Policisë Bashkiake, duhet mbajtur procesverbali përkatës dhe kopja e tij i duhet dhënë personit posedues.

Nga ana tjetër, vlerësojmë se veprimet e kryera nga shtetasi S. S., ndoshta në padijeni të plotë nga ana e tij si veprime të kundërligjshme, janë kryer për shkak të pamundësisë për të siguruar të ardhura të mjaftueshme dhe të një jetese më të mirë për familjen. Një nga aktivitetet me të cilin merren pjesëtarët e komunitetit rom është mbledhja e bidonave plastike, apo e kanaçeve në vendet e hedhjes së mbeturinave, për t'i shitur më pas në pikat përkatëse të grumbullimit të tyre. Ne vlerësojmë, se mungesa e kushteve minimale të jetesës së anëtarëve të këtij minoriteti është një problem serioz, jo vetëm për ata vetë si individë, por edhe për mënyrën e ofruar nga shteti dhe shoqëria jonë për integrimin e plotë të Romëve në shoqëri. Kjo situatë bën që ky minoritet të ndihet i diskriminuar, i pabarabartë me pjesën tjetër të popullsisë dhe me mungesë shprese për të ardhmen.

Adresimi i problematikave e zgjidhjes së tyre për këtë komunitet kërkon koordinim ndërinstucional dhe duhet të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe i gjithë pranuar për mbrojtjen efektive të të drejtave të tij. Ndaj kërkohet marrja e masave të qëndrueshme e mbështetëse me qëllim që ky komunitet të jetojë me standardet e pjesës tjetër të popullsisë në vendin tonë. Nga institucioni i Avokatit të Popullit është rekomanduar në vijimësi përfshirja në programet e formimit profesional dhe punësimin e pjesëtarëve të komunitetit rom si dhe marrja e masave për përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës.

Ne vlerësojmë se rasti në fjalë nuk duhet të kalonte pa u trajtuar, analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë konkrete ndaj punonjësve të policisë që i kanë kryer ato. Nga ana juaj duhet të ishte verifikuar pretendimi i ankuesit se punonjësit e policisë i kanë marrë karrocën biçikletë, duhej të thirrej e pyetëj ai, të pyeteshin punonjësit e organit tuaj që e kanë kapur atë, të bëhej ballafaqimi nëse do të ishte i nevojshëm, si dhe verifikime të tjera që do t'i shërbenin zbulimit të së vërtetës.

Për sa më sipër dhe me qëllim parandalimin e rasteve të tilla në të ardhmen, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në gërmën “b” të nenit 21 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË:

1. Analizimin e këtij rasti dhe nxjerrjen e përgjegjësi përkatëse të personave përgjegjës.
2. Marrjen e masave të nevojshme për kthimin e mjetit (karrocës) së bllokuar shtetasit S. S..
3. Marrjen e masave të nevojshme për trajnimin e punonjësve të Policisë Bashkiake Tiranë me qëllim njohjen dhe respektimin e akteve normative në fuqi që rregullojnë veprimtarinë e këtij organi gjatë kryerjes së detyrave dhe për respektimin e të drejtave ligjore të shtetasve.
4. Zbatimin me korrektesë të dispozitave ligjore lidhur me veprimet që duhet të kryejnë punonjësit e Policisë Bashkiake në rastet kur konstatojnë persona që marrin mbetje të riciklueshme nga kontenierët e grumbullimit të tyre, si dhe mbajtjen, hartimin e procesverbalit në të gjitha rastet e bllokimit/sekuestrimit të sendeve dhe dhënien e kopjes së tij poseduesve të tyre.
5. Marrjen e masave të nevojshme për përgjithësimin e këtij rasti në efektivin e Policisë Bashkiake Tiranë me qëllim që raste të tilla të mospërsëriten më në të ardhmen.
6. Marrjen e masave të nevojshme me qëllim informimin e shtetasve duke vendosur tabela pranë kontenierëve të depozitimit të mbeturinave me mbishkrimin se ato janë pronë shtetërore dhe marrja e tyre është e dënueshme ligjërisht.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi